REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA R. TELHARAJ
ADRESA Rr. "ISMAIL QEMALI,
PALL. NR. 12, Kt. I - TIRANE"
TEL: 672072286

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 964** **Nr. koleksioni: 566**

**Tirane më 09/05/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2024052800061310392

A20240528000613I0392

**KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI**

Sot, më datë _____/05/2024, para meje Notere EDLIRA R. TELHARAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr. "ISMAIL QEMALI, PALL. NR. 12, Kt. I - TIRANE", u paraqit personalisht:

**DHURUES**:

**NICOLA MOSCA**, atësia Giuseppe , shtetas Italian, lindur në ITALIA dhe banues në ITALIA, me lindur më 26/03/1965, gjendja civile "divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte italjane me numer YC4285069.

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhururesi**")*

**PRANUES I DHURIMIT**:
**ROSSANA PARMEGGIANI**, atësia Enrico, shtetase britanike, lindur në ITALI më 27/02/1974, gjendja civile "e divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Britanike nr 575918417.

Ne prezence te perkthyesit te gjuhes italjane Klodian Kovaçi I cili deklaroi se perktheu dokumentin nga shqipja ne italisht

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")*

***TE DHENA TE PARAPRAKE***

**A.** Shoqëria SPYRAL INVESTMENT sh.p.k, është regjistruar si person juridik ne Qendren Kombetare të Regjistrimit te Biznesit me NIPT M41605031V, ne date themelimi 6/03/2024, me kapital me vlerë **500.000 leke (peseqinde mije)** dhe ka status aktiv.

**B.** Kuotat e ortakut dhurues rezultojne te lira pa barra dhe lehtesisht te transferueshme te pala pranuese e dhurimit.

**C.** Pranuesi i dhurimit deklaron se e njeh gjendjen e shoqerise e njeh e ka verifikuar ate dhe e pranon kalimin e kuotes ne favor te saj sipas parashikimeve ne kete akt.

**NENI 1**
**Objekti**

**1.1** Objekt i kësaj kontrate është kalimi nga Dhuruesi te Pranuesi i Dhurimit i: 1(nje) kuote te barabarte me 100% (njeqinde perqind ) te kapitalit të shoqërisë **"**SPYRAL INVESTMENT**"** sh.p.k, pa kundershperblim dhe pa kusht.

**1.2** Zhveshja e Dhuruesit nga te drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qenia pronar mbi 1(nje) kuote te barabarte me 100% (njeqinde perqind) te pjeseve të kapitalit të shoqërisë **"**SPYRAL INVESTMENT**"** sh.p.k objekt i dhurimit, nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate.

**NENI 2**
**Kalimi i pronësisë**

**2.1** Me nënshkrimin e kësaj kontrate realizohet kalimi i 1 (nje) kuote me vlere te barabarte me 100% te pjeseve te kapitalit te shoqerise **"**SPYRAL INVESTMENT" sh.p.k nga Dhuruesi te

A202405280006131O392

Dhuruesi zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia që kishte mbi kete shoqëri.

2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pranuesi i Dhurimit bëhet zotërues edhe i 1(nje) kuote te barabarte me 100 % te pjeseve te kapitalit te shoqerise, duke marre persiper te gjitha të drejtat dhe detyrimet qe burojne nga qenia pronar mbi 100% të aseteve të shoqërisë.

**NENI 3**

**Deklarime të palëve**

3.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesin e Dhurimit se, kuotat e kapitalit te shoqerise, që i transferohen Pranuesit te Dhurimit, pa asnje kusht dhe kundershperblim, jane te lira nga çdo barrë apo rëndesë tjetër, dhe menjëherë lirisht të transferueshme te te tretet dhe mbi to nuk ka asnjë të drejtë juridike të të tretëve perveç Pranuesit te Dhurimit.

3.2 Pranuesi i Dhurimit, deklaron se e njeh gjendjen e shoqërisë, e pranon transferimin nëpërmjet dhurimit ne favor te saj, duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga qenia pronar mbi kuoten objekt dhurimi, te barabarte me 100% te kapitalit, sipas gjendjes se shoqerise te njohur prej tij e te pranuar pa verejtje.

**NENI 4**

**Data efektive e kontratës**

4.1 Kjo kontratë është e parevokueshme, e pakthyeshme, efektive, e detyrueshme për palët dhe trashëgimtarët e tyre, që nga data e nënshkrimit të saj.

**NENI 5**

**Zgjidhja e Kontratës**

5.1 Asnjë nga palët nuk mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë.

**NENI 6**

**Hartimi i Kontratës, aktet bashkëlidhur**

6.1 Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje të barazvlershme, në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.

6.2 Kjo Kontratë zëvendëson çfarëdolloj marrëveshje, kontrate ose çfarëdolloj dokumenti tjetër dhe është e vetmja Kontrate detyruese për Palët në lidhje me objektin e Dhurimit

**NENI 7**

**Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni**

7.1 Kjo Kontratë është hartuar ne bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

7.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, nëse vetë palët me ndihmë juridike vazhdojnë të mos t'i kuptojnë e zbatojnë, si dhe në rast se vetë palët nuk gjejnë mirëkuptim, mosmarrëveshjet bëhen objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës.

**NENI 8**

**Interpretimi i Kontratës në tërësi**

8.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndveshtrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

A202405280006131O392

*Kontrata iu lexua palëve me zë të lartë e të qartë nga unë Noteri. U lexua prej perkthyesit te gjuhes italjane e psir palet palët deklarojnë se e kuptuan, e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time. Unë noterja e legalizoj regullisht, ne perputhje me ligjin.*

**DHURUES**

**NICOLA MOSCA**

NICOLA MOSCA

**PRANUES DHURIMI**

**ROSSANA PARMEGGIANI**

Rossana Parmeggiani

**Perkthyes Klodian Kovaçi**

Klodian Kovaçi

Klodian Kovaçi
Përkthyes Zyrtar
Traduttore Accreditato
0698193399

**NOTER**

EDLIRA R. TELHARAJ